



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1301-1/16 prot.

Datë 20.06.2025

V E N D I M

Nr. 800/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.06.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.765/2025, datë 11.06.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Muca” shpk me NIPT K01421002H Autostrada Tiranë-Durrës, km.13, fshati Picar
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Zdrava 07” SHPK
Lagjja Saver, Autostrada Lushnje - Fier km 4
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 11.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.765/2025, ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik “Muca” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1666/7 prot., datë 18.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1301/13 prot., datë 20.06.2025, autoriteti kontraktor, *Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a*, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 765/2025, datë 11.06.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar. Bashkëlidhur po ju dërgojmë.”.

-Procesverba; të rivlerësimit i mabjtur nga KVO, me datë 17.06.2025;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 1666/7 prot., datë 18.06.2025, protokolluar me tonën nr. 1301/13 prot., datë 20.06.2025, autoriteti kontraktor, *Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a*, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 765/2025, datë 11.06.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni

i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar. Bashkëlidhur po ju dërgojmë: ”.

-Procesverbal të rivlerësimit i mbajtur nga KVO, me datë 17.06.2025;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar operatorin ekonomik “Fral 2000” SHPK në përputhje me vendimin e Komisionit të Shqurtimit të Ankesave dhe konstatim të KPP-së në vendim me Nr.765/2025, datë 11.06.2025, duke e skualifikuar këtë subjekt, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me anë procesverbalit të rivlerësimit i mbajtur nga KVO, me datë 17.06.2025. Gjithashtu, me anë të këtij procesverbali të rivlerësimit, autoriteti kontraktor ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik, se ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë të kualifikuar, dhe pas rivlerësimit të datës 17.06.2025, ka skualifikuar gjithashtu edhe operatorin ekonomik “Zdrava 07” Shpk, pasi rezultoi anomalisht i ulët.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-45761-04-22-2025 me objekt: “Blerje dhe vendosje rafte metalike për nevojat e Autoritetit Rrugor Shqiptar”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 05.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

